



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 74 prot

Tiranë, më 6.02 2026

VENDIM

Nr. 2 datë 6.02 2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 3/2/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 3.2.2026 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për një ndryshim në Vendimin nr. 419 datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të rishikohen pagat e zjarrfikësve që janë në shërbim 24 orë të cilët nuk trajtohen me shtesa për turnet siç e ka kodi i punës për turnin e 2-të apo për turnin e 3-të.

2. Për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, propozuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të rishikohet paga për pozicionin e punës të Sekretarit të Përgjithshëm i cili duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë me atë të pozicionit të nënkryetarit, nisur për nga rëndësia dhe përgjegjësia ligjore që ka ky pozicion pune.

Pika 1 (a) të ndryshohet si vijon:

Pika 11 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

Kufijtë e pagave bazë të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore janë nga 50 000–57 000 lekë në muaj. Këshilli i bashkisë vendos paga mbi këto nivele për punonjës të profesioneve të veçanta teknike. Në këtë rast, shtesat në paga përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.

Pika 2 (a) të ndryshohet si vijon:

Kufijve maksimalë të elementit “Pagë për pozicion” për klasat III-1, III-2, III-3 dhe kufijve minimalë dhe maksimalë për klasat IV-4, IV-1, IV-2, IV-3 në lidhjet nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 dhe nr. 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe vlerat e pikës 11, të ndryshuar, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe politikës së rritjes së pagave; Pozicionet e përfshira në këto kategori përshijnë profesione të specializuara si manovrator i makinerive të rënda, shofer i mjeteve të specializuara të transportit.

Pika 2 (a) të ndryshohet si vijon:

Kufijve maksimalë të elementit “Pagë për pozicion” për klasat III-1, III-2, III-3 dhe kufijve minimalë dhe maksimalë për klasat IV-4, IV-1, IV-2, IV-3 në lidhjet nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6 dhe nr. 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe vlerat e pikës 11, të ndryshuar, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe politikës së rritjes së pagave; Në lidhjet 2, 3, 4, 5 dhe 6 të bëhen ndryshimet e mëposhtme përkatëse;

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
IV	IV-2	Specialist/Inspektor	1 ose 2, ose 3	Nga 53,125 deri 85,000
	IV-3	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 51,050 deri 75,000
	IV-4	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 50,000 deri 65,000

Të rishikohet paga për kategorinë IV të nëpunësve civilë në bashki, klasifikuar si ekzekutive, si dhe duhet një rritje e mëtejshme e kufirit minimal të pagës bazë, ku përfshin punonjës të cilës kanë nivel arsimor bachelor ose master dhe kanë aktualisht nivelin më të ulët të pagave.

3. Për projektvendimin **“Për disa ndryshime në Vendimin nr. 425, datë 26.6.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor para universitar”**”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të ndryshohen numrat rendorë të pikës 2 (a) me tabelat përkatëse:

Pozicionet me numër rendor 1, 2 dhe 7 deri në 11 të lidhjes nr. 1, pozicionet me numër rendor 1 dhe të lidhjes nr. 2 dhe pozicionet me numër rendor 1 dhe 5 deri në 8 janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe politikës së rritjes së pagave.

4. Për projektvendimin **“Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë Rrugore 2030 dhe Planit të Veprimit 2026-2028”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Masat e propozuara në draft Strategji lidhur me pushtetin vendor përfshijnë:

Zhvillimi i zgjidhje inovative të infrastrukturës; rritja e përdorimit të transportit publik dhe parandalimi dhe edukimi për sigurinë rrugore do të forcohen si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel vendor me qëllim përgjysmimin e numrit të fataliteteve në aksidente rrugore deri në fund të vitit 2030;

Njësitë vendore duhet të përfshihen më fuqishëm në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve për sigurinë rrugore në nivel vendor. Përtej përmirësimeve në sigurinë e automjeteve dhe sjelljen e përdoruesve të rrugës, ky është një nga sektorët ku janë identifikuar mundësitë më të mëdha për përparim drejt objektivit "Vizioni Zero" (Vizioni Zero për humbje jete në rrugë);

Ndarje e të dhënave dhe bashkëpunim ndërmjet palëve të interesit, së bashku me një alokim më të mirë të fondeve në nivel kombëtar dhe vendor;

Bashkëpunimi me komunitetet vendore duke inkurajuar krijimin e Grupeve Teknikë Vendorë për Sigurinë Rrugore, të cilët do të kontribuonin gjithashtu në identifikimin dhe inspektimin e zonave me risk të lartë në rrugët vendore;

Veprimet e parashikuara në draft Planin e Veprimit me ndikim në pushtetin vendor janë:

Pjesëmarrja në 12 grupet e ekspertëve të sigurisë rrugore për propozime masash përmirësuese me kosto të mesme/të ulëta dhe mbështetja buxhetore e këtyre masave;

Rishikimi i kufizimeve të shpejtësisë të shënuara në rrugët lokale dhe urbane dhe ndryshimi/përshtatja aty ku është e nevojshme;

Vendosja e kamerave të shpejtësisë dhe sinjalistikë tjetër inteligjente që ulin në mënyrë efektive shpejtësinë e automjeteve në 12 lokacione dhe integrimi i tyre me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut;

Në bashkëpunim me Institutin e Transportit, regjistrojnë dhe monitorojnë Indikatorët Kryesorë të Përformancës që lidhen me shpejtësinë mesatare.

5. Për projektvendimin **“Për miratimin e Planit Kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036”** propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Në kapitullin IV, në paragrafin e tretë të relacionit, referenca ligjore rezulton e shfuqizuar, konkretisht Ligji nr.8756 “Për emergjencat civile” shfuqizohet me Ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen Civile", neni 74, ndërsa ligji nr.48/2018 ka të bëjë me disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2010 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë ". Planifikimi dhe zhvillimi i territorit rregullohen me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Të përfshihen në grupin e punës përfaqësues të pushtetit vendor për të mundësuar koordinimin e masave të marra në nivel qendror dhe vendor;

Aneksi II i Planit përkrah institucioneve të tjera të shtohet dhe pushteti vendor së bashku me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse;

Aneksi II “Detaje mbi tendencat klimatike të vëzhguara dhe të parashikuara në nivel vendor” përmban të dhëna vetëm për disa bashki. Nga konsultimi i Planeve Vendore të Përshtatjes për tetë bashki vërejmë nevojën për të dhënat specifike të faktorëve klimaterikë për secilën prej bashkive. Kjo do të ndihmonte dhe në hartimin e masave përkatëse për tu përfshirë në Planet Vendore për të gjitha bashkitë;

Të qartësohet kostoja totale e planit për pushtetin vendor në tërësi dhe për bashkitë individuale dhe nëse bashkitë do të përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit dedikuar zbatimit të masave të këtij plani, si dhe zgjatjen e afatit të zbatimit të këtij plani, për të mundësuar gjetjen e burimeve financiare të nevojshme për zbatim;

Në sektorin e Zhvillimit Urban, propozohet të integrohet:

Formalizimi i partneriteteve Bashki–Operatorë Ujësjellës Kanalizime për auditime klimatike të rrjeteve dhe plane mirëmbajtjeje parandaluese.

Në sektorin e Biznesit, sugjerohet: Integrimi i riskut klimatik në vlerësimet e riskut të biznesit lokal.

Në sektorin e Turizmit, sugjerohet: Integrimi i kriterëve të reziliencës klimatike në restaurimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me institucionet e kulturës dhe bashkitë.

Në sektorin e Pylltarisë, te masa e përshtatjes ”Rritja e aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike në parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura”, sugjerohet që listës t’i shtohen edhe Parku Kombëtar i Dajtit dhe Parku i Bizë–Martanesh, për shkak të rëndësisë së tyre ekologjike dhe rolit që luajnë në rritjen e reziliencës klimatike në territorin e Bashkisë Tiranë. Në sektorin Ndërsektorial, masa: ”Krijimi dhe zbatimi i një fushate për të ndërgjegjësuar publikun mbi rëndësinë e mjedisit natyror dhe rolin e tij në përballimin e ndryshimeve

klimatike, duke ndihmuar në zvogëlimin e ndikimeve të ngjarjeve atmosferike ekstreme (si përmblytjet apo valët e të nxehtit). Në kolonën “Përgjegjës kryesor” të përfshihen edhe Bashkitë, duke marrë parasysh rolin e tyre në zbatimin e drejtpërdrejtë të fushatave të ndërgjegjësimit dhe komunikimit me komunitetin në nivel vendor.

Prokurimet e gjelbra: ”Promovimi i prokurimeve të gjelbra për mallrat, shërbimet dhe punimet, për të mbështetur objektivat mjedisore dhe objektivat më të gjera të zhvillimit të qëndrueshëm” Në kolonën “Përgjegjës kryesor” të përfshihen edhe Bashkitë, duke pasur parasysh rolin e tyre në zbatimin e procedurave të prokurimit publik në nivel vendor.

Në sektorin e Transportit, propozohet:

Integrimi i masave për lehtësimin e aksesit të qytetarëve në informacion dhe shërbime, përmes digjitalizimit të sistemeve të pagesës elektronike dhe biletimit, me qëllim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe përdorimit të transportit publik.

Vendosja e tabelave digjitale në stacionet e autobusëve për të shfaqur kohën e mbërritjes dhe itineraret.

Elektrifikimi dhe Modernizimi i Flotës së Automjeteve të Bashkive me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe reduktimi i emetimeve nga transporti përmes zëvendësimit të flotës aktuale të automjeteve me automjete elektrike (EV), ndërtimit të infrastrukturës për karikim dhe përshtatjes së politikave të Bashkive ndaj sfidave klimatike. Kjo zbatohet përmes

Vlerësimit të politikave dhe flotës ekzistuese;

Shqyrtimi i politikave aktuale të lëvizshmërisë dhe reagimit në kushte ekstreme.

Hartimi i një udhëzuesi për tranzicionin drejt flotës elektrike dhe integrimin gradual të saj.

Zhvillimi i infrastrukturës së karikimit;

Identifikimi i zonave prioritare për instalimin e stacioneve të karikimit në hapësira publike dhe objekte bashkiake;

Nxjtja e partneritetit publik-privat për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të karikimit.

Blerja dhe testimi i automjeteve elektrike:

Përgatitja e një plani shumëvjeçar blerjeje për automjete EV, duke filluar me sektorët operativë me emetime më të larta;

Sigurimi që modelet e përzgjedhura janë funksionale në kushte ekstreme.

Sensibilizimi dhe nxjtja e përdorimit të automjeteve EV:

Organizimi i fushatave publike për përfitimet e automjeteve elektrike;

Hartimi i paketave stimuluese për operatorë dhe banorë (p.sh. përparësi në parkim, ulje tarifash).

Mbështetja teknologjike dhe operacionale:

Vendosja e sistemit për monitorim të flotës së automjeteve dhe rrjetit të karikimit në kohë reale;

Trajnim për mirëmbajtjen e automjeteve EV dhe menaxhimin e sistemeve të karikimit nga punonjësit teknikë të Bashkisë Tiranë.

Monitorimi i progresit dhe rishikimi i planit të përdorimit të automjeteve EV:

Krijimi i indikatorëve të matshëm për nivelin e elektrifikimit, konsumin e energjisë dhe reduktimin e emetimeve;

Rishikimi periodik i planit bazuar në të dhëna empirike dhe risitë teknologjike.

Në sektorin e Mbetjeve:

Në Planin Kombëtar kjo çështje trajtohet në mënyrë të kufizuar; sugjerohet zgjerimi dhe integrimi i saj në mënyrë më të detajuar brenda paketës së masave Ndërsektoriale ose në kategorinë Zhvillimi Urban, konkretisht:


Mbështetja e politikave të Menaxhimit të Mbetjeve për reduktimin e mbetjeve dhe e nismave të tjera që nxisin kalimin në ekonominë qarkulluese.

Kryerja e Vlerësimit të Riskut për ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike në objektet e menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Tiranë, mund të realizohet përmes hapave:

Integrimi i masave për ndryshimet klimatike në Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve: Integrimi i masave specifike për të trajtuar risqet e identifikuar, si përmirësimi i infrastrukturës ose ndryshimi i proceseve;

Monitorimi dhe përditësimi: Vendosja e një sistemi për të monitoruar masat e integruara në planin e menaxhimit të mbetjeve duke vlerësuar ndikimet klimatike dhe përditësimin e këtyre planeve bazuar në ndryshimet e reja klimatike;

Rishikimi i mekanizmave financiarë dhe tariforë bashkiakë: Përshtatja e strukturës së tarifave dhe skemave të financimit për shërbimet e menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve, me qëllim mbështetjen e investimeve në masa reziliente ndaj klimës, përmirësimin e trajtimit të mbetjeve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të sistemit.



Z. Aldrin Dalipi
Kryetar/Bashkëkryetar

Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë

Z. Ervin Demo
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

